

LIGJ
Nr. 111/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA
QEVERI TË NDRYSHME, NËN FONDIN E PËRBASHKËT EUROPIAN TË
BALLKANIT PERËNDIMOR, DHE BERZH, NËN FONDIN E AKSIONARËVE TË
VEÇANTË TË BERZH-IT, PËR MBIKËQYRJEN E PROJEKTIT TË RRUGËVE
DYTËSORE DHE LOKALE NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administratore e fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme, nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, dhe BERZH, nën fondin e aksionarëve të veçantë të BERZH-it, për mbikëqyrjen e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri, me një shumë prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8693, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Marrëveshje Granti Nr: C25851rev/EBSF-2013-01-17 dhe C25852rev/WBJF-2013-01-01

MARRËVESHJE GRANTI

PËR MBIKËQYRJEN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE NË
SHQIPËRI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIMSI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT TË
SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME NËN FONDIN E PËRBASHKËT
EUROPIAN TË BALLKANIT PERËNDIMOR DHE BERZH NËN FONDIN E
AKSIONARËVE TË VEÇANTË TË BERZH

(datë)

MARRËVESHJE GRANTI

Marrëveshje Granti nr: C25851rev/EBSF-2013-01-17 dhe C25852rev/WBJF-2013-01-01, datë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave ("Marrësi") dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka" ose "BERZH") me selinë e saj në adresën One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbretëria e Bashkuar, një institucion ndërkombëtar financiar i krijuar sipas Marrëveshjes Themeluese të Bankës të nënshkruar në Paris më 29 maj 1990, i cili vepron si administratore e fondeve të grantit që gjenden në Fondin e Aksionarëve të Veçantë të BERZH-it dhe Fondin e Përbashkët European të Ballkanit Perëndimor, të siguruara nga Qeveri të ndryshme (bashkërisht, "Donatorët").

PREAMBULË

Duke marrë në konsideratë se Bankës i është kërkuar të konsiderojë ofrimin e bashkëpunimit teknik për Marrësin në formën e shërbimeve financiare të konsulencës për mbikëqyrjen e punëve civile të kontraktuara për një Projekt të Rrugëve Dytësore dhe Lokale ("Projekti"), duke përfshirë aktivitetet e monitorimit, inspektimit dhe mbikëqyrëse ("Shërbimet").

duke marrë në konsideratë se FSHZH duhet të angazhojë një konsulent ("Konsulentin") në pajtim me Politikën dhe Rregullat e Prokurimeve dhe procedurave të tjera të BERZH-it;

duke marrë në konsideratë se FSHZH do të lidhë një Kontratë Konsulente me Konsulentin për dhënien e Shërbimeve, ("Kontratë Konsulente");

duke marrë në konsideratë se Konsulentin do të bjerë dakord të ofrojë Shërbimet siç përkufizohen në Kontratën e Konsulencës me termat dhe kushtet e parashikuara në të për një shumë maksimale prej 2.788.922,10 euro;

duke marrë në konsideratë se në pajtim me Marrëveshjen e Financimit të Bashkëpunimit Teknik ndërmjet Donatorit dhe Bankës, Donatori ka aprovuar dhe rënë dakord të ofrojë fonde deri në 1.500.000 euro me bazë granti ("Granti") për të financuar Shërbimet e një Konsulentin me termat dhe kushtet e parashikuara në poshtë:

duke marrë në konsideratë se Marrësi do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në pajtim me ligjin shqiptar për t'i ofruar Grantin FZSHH-së për qëllimin e specifikuar në termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje;

duke marrë në konsideratë se Marrësi do të garantojë si kusht për marrjen e Grantit që, duke njohur marrjen e përfitimit të Shërbimeve, FZSHH-ja do të respektojë të gjitha detyrimet kontraktuale të shprehura në këtë Marrëveshje Granti si të FZSHH-së;

duke marrë në konsideratë se FZSHH ka rënë dakord të kontribuojë një shumë prej 1.288.922,10 euro nga shumat e një huaje të ofruar atij sipas një marrëveshjeje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve;

duke marrë në konsideratë se Banka ka rënë dakord të administrojë Grantin sipas termave dhe kushteve të parashikuara;

rrjedhimisht, Palët bien dakord për termat specifike të mëposhtme:

Neni I Përkufizime

1.01 Përkufizime dhe interpretimi

Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme me germa kapitale kanë kuptimet e caktuara më poshtë:

- a) Kostoja e Porosive: është kostoja për Shërbimet.
- b) Banka ose BERZH-i: është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

c) FZSHH është Fondi Shqiptar i Zhvillimit ("FSHZH"), pala së cilës do t'i jepen Shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës.

d) Angazhimi i FSHZH-së: është kontributi financiar që FSHZH do të bëjë kundrejt kostos së dhënies së Shërbimeve.

e) Konsulenti: është pala e cila do të kryejë Shërbimet.

f) Kontrata e Konsulencës: është marrëveshja e lidhur, ose që do të lidhet, ndërmjet FSHZH-së dhe Konsulentit për dhënien e Shërbimeve.

g) Vendi i porosisë: është Shqipëria.

h) Donatori: është dhënësi i fondeve të Grantit, siç specifikohet në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

i) Granti: është shuma e fondeve që i ofrohen Bankës nga Donatori, si administratore, për qëllimin e financimit të Kontratës së Konsulencës.

j) Marrëveshje Granti: është kjo Marrëveshje dhe të gjitha shtojcat e bashkëlidhura në të, e cila mund të ndryshohet herë pas here.

k) Shuma maksimale e kontratës: është shuma maksimale që duhet t'i paguhet Konsulentit sipas një Kontrate Konsulencie, duke përfshirë të gjitha tarifat, dietat dhe shpenzimet.

l) Drejtuesi i operacionit: është anëtari i personelit të Bankës përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës.

m) Marrësi: është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

n) Shërbimet: janë Shërbimet e kryera nga Konsulenti për FSHZH-në sipas përcaktimit në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.

b) Në këtë Marrëveshje, referenca ndaj një Akti është referencë tek ky akt dhe tek rregulloret e hartuara në pajtim me këtë akt dhe ky Akt dhe rregullore mund të ndryshohen ose modifikohen herë pas here dhe mbeten në fuqi, dhe tek çdo akt dhe rregullore që mund të miratohen dhe kanë fuqinë e plotësisht ose mbizotërimit ndaj këtij akti dhe rregulloreve.

c) Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një gjinie përfshin një referencë ndaj të gjitha gjinive të tjera, numri njëjës do të përfshijë shumësin dhe anasjelltas, ndërsa referencat ndaj personave përfshijnë organizatat e regjistruara, të paregjistruara dhe partneritetet. Referenca ndaj një personi do të përfshijë trashëgimtarët dhe cedimet e lejuara.

Neni II Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord t'i ofrojë Marrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, Grantin në një shumë që nuk kalon 1.500.000 euro ose ekuivalentin e saj.

b) Granti do të përdoret vetëm për të financuar Shërbimet gjatë afatit të angazhimit të Konsulentit.

2.02 Disbursimi

a) Marrësi dhe Banka bien dakord që Banka do të autorizohet të bëjë disbursime drejtpërdrejt tek Konsulenti në emër të FSHZH-së.

b) Shuma e Grantit do të disbursohet nga Banka drejtpërdrejt tek Konsulenti në emër të dhe sipas udhëzimeve të FSHZH-së në pajtim me dispozitat e Nenit III të Kontratës së Konsulencës.

c) Me marrjen e një fature dhe të dokumenteve mbështetëse nga Konsulenti, të paraqitura në pajtim me dispozitat e skedulit B të Kontratës së Konsulencës, FSHZH-ja pa vonesë do të

kontrollojë dhe verifikojë faturën dhe përmbushjen e kënaqshme të atyre Shërbimeve të Konsulentit me të cilat lidhet fatura.

d) Nëse ato Shërbime konstatohen të jenë të pranueshme, dhe FSHZH-ja është e bindur që shumat e caktuara në faturë përputhen me shumat e parashikuara në skedulin B të Kontratës së Konsulencës, fatura, dokumentet mbështetëse dhe një pasqyrë (siç përcaktohet në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit) që certifikon aprovimin e Shërbimeve duhet t'i kalohet Bankës për pagesë në adresën e përcaktuar në Rregullat për Përgatitjen e Faturave.

e) FSHZH-ja do t'i paguajë Konsulentit 46,22 % të Kostove të Porosisë ("Angazhimi"). Angazhimi nuk do të kalojë 1.288.922,10 euro. FSHZH-ja do t'i japë Bankës të gjitha ato prova që Banka mund të kërkojë për pagesat e kryera nga FSHZH-ja Konsulentit (duke përfshirë, ku është e nevojshme, faturimet fillestare dhe faturat). FSHZH-ja gjithashtu ofron një Deklaratë Aprovim të Shërbimeve të Konsulencës në formatin e gjendur në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje Granti në lidhje me Shërbimet e përmbushura nga Konsulenti të cilat janë paguar tërësisht nga FSHZH-ja.

2.03 Taksat dhe detyrimet

a) FSHZH-ja bie dakord që fondet e Grantit të mos përdoren për të financuar asnjë taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) në lidhje me Shërbimet e kësaj Marrëveshjeje Granti të detyrueshme sipas ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi në Vendin e Porosisë.

b) FSHZH-ja do të njoftojë Bankën nëse ndonjë takse indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e kërkueshme në lidhje me Kontratën e Konsulencës.

c) FSHZH-ja bie dakord që çdo taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) e pagueshme do t'i paguhet Konsulentit nga FSHZH-ja.

d) Nëse një taksë indirekte (duke përfshirë TVSH-në) është e kërkueshme, në momentin e dhënies së certifikatës Bankës sipas dispozitës 2.02 (d), FSHZH-ja do të vërtetojë gjithashtu pagesën prej saj të taksave indirekte (duke përfshirë TVSH-në) të pagueshme për çdo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe merr përsipër të paguajë taksën indirekte (duke përfshirë TVSH-në) për këtë faturë.

e) Mospagimi nga FSHZH-ja e ndonjë takse indirekte (duke përfshirë TVSH-në) mund të rezultojë në prishjen e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me dispozitën 5.03.

Neni III

Ekzekutimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka, Marrësi dhe FSHZH-ja do të bashkëpunojnë plotësisht në lidhje me administrimin e Kontratës së Konsulencës.

Banka, Marrësi dhe FSHZH-ja herë pas here dhe me kërkesë të çdonjërit prej tyre do të shkëmbejnë mendime në lidhje me përparimin e Projektit, Shërbimeve, qëllimeve për të cilat jepet Granti, përmbushjen e detyrimeve të FSHZH-së sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe përmbushjen e detyrimeve të FSHZH-së dhe Konsulentit sipas Kontratës së Konsulencës dhe i japin palës tjetër të gjithë informacionin përkatës që pala tjetër mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

b) FSHZH-ja do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar në natyrën ose objektin e Projektit, Shërbimeve ose punës apo operacioneve të FSHZH-së ose të çdo ngjarjeje ose kushti tjetër që mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme përmbushjen e Projektit, ose Shërbimeve ose kryerjen e aktivitetit apo operacioneve të FSHZH-së.

c) Pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, FSHZH-ja nuk do të bëjë asnjë ndryshim të konsiderueshëm, duke përfshirë vendimin në lidhje me porositë dhe nënkontraktimin, në Kontratën e Konsulencës pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga Banka pëlqim ky që nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Në çdo rast, të gjitha ndryshimet e Kontratës së Konsulencës do t'i njoftohen Bankës nga FSHZH-ja.

3.02 Regjistra dhe raporte

a) FSHZH-ja:

(i) do të mbajë procedura dhe regjistra të përshtatshëm për të regjistruar dhe monitoruar progresin e shërbimeve (duke përfshirë koston e tyre dhe përfitimet që dalin prej tyre), dhe për të identifikuar shërbimet e financuara nga shumat e Grantit, dhe do t'ua ofrojë këto regjistra përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës.

(ii) do të mbajë llogari dhe pasqyra financiare (balance, pasqyra të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra mbështetëse) të nevojshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e Shërbimeve, duke përfshirë kostot dhe përfitimet e përfutuara prej këtyre Shërbimeve, dhe për t'i dhënë Bankës, sipas kërkesës, kopje të këtij informacioni me detaje që Banka do të ketë kërkuar në mënyrë të arsyeshme.

(iii) do t'u japë mundësi përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës, të vizitojnë çdo mjedis të përfshirë ose të përmendur në Projekt ose Kontratën e Konsulencës dhe të shqyrtojnë Shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe çdo fabrikë, instalim, kantier, punë, ndërtesa, prona, pajisje, regjistra dhe dokumente që kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrimeve të FSHZH-së ose Konsulentit sipas kësaj Marrëveshjeje ose Kontratës së Konsulencës.

(iv) do të japë përfaqësuesve të Bankës të gjithë atë informacion që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin dhe Shërbimet, koston e tyre dhe, kur është e përshtatshme, përfitimet që nxirren prej tyre, dhe shpenzimin e shumave të Grantit.

(v) do të ofrojë ose marrë masa për t'u ofruar, përfaqësuesve të Bankës menjëherë pas përgatitjes së tyre, çdo plan, specifikim, raport, kontratë, dokument (duke përfshirë artikujt që dalin nga Kontrata e Konsulencës) dhe çdo modifikim material të saj ose shtesë, me ato hollësi që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

b) Menjëherë pas përfundimit të shërbimeve, FSHZH-ja do të përgatisë dhe t'i japë Bankës një raport në gjuhën e specifikuar, me atë shtrirje dhe detaje që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe operimin e Shërbimeve, koston dhe përfitimet e nxjerra dhe që do të nxirren prej tyre, dhe punën e FSHZH-së, Konsulentit dhe Bankës të detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së Grantit dhe Kontratës së Konsulencës, sipas rastit.

c) Të gjitha raportet dhe regjistrat e prodhuara nga FSHZH-ja do të përpilohen në formatin *Microsoft Word* dhe/ose *Excel*, të përputhshme me formatin *Acrobat* dhe jepen në format elektronik dhe letër.

3.03 Konfidencialiteti

Përveç se me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, ADF dhe Marrësi nuk deklarojnë apo bëjnë apo lejojnë që agjentët ose nënkontraktuesit e tyre të deklarojnë kundrejt palëve të treta apo të përdorin për qëllimet e tyre ndonjë informacion në lidhje me Shërbimet, Projektin ose Bankën, duke përfshirë informacionin në lidhje me Kontratën e Konsulencës. ADF ose Marrësi mund t'i japë këto të dhëna dhe informacion nëse kërkohet me ligj apo rregullore të zbatueshme, por vetëm atë pjesë të informacionit që, në masën e lejuar nga ligji përkatës apo kërkesa rregullatore është e kërkuar ligjërisht për t'u dhënë. Nëse bëhet një kërkesë e tillë ADF dhe Marrësi do të njoftojnë menjëherë Bankën.

3.04 Kryerja e operacioneve

Përveç kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, FSHZH-ja do të zhvillojë aktivitetin dhe operacionet e veta (duke përfshirë operacionet e çdo filiali) në pajtim me standardet dhe praktikën e qëndrueshme administrative, teknike, financiare dhe mjedisore të njohura ndërkombëtarisht nën mbikëqyrjen e menaxhimit të kualifikuar dhe me përvojë të asistuar nga personeli kompetent në numër të përshtatshëm.

3.05 Mbështetja e marrësit

Marrësi:

- (i) do të përmbushë rregullisht të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (ii) do të mbështesë FSHZH-në në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë marrjen e të gjitha masave të nevojshme apo të dëshirueshme legjislative, rregullatore apo të tjera, dhe duke caktuar dhe ofruar, apo marrë masa për të ofruar fonde dhe mbështetje për FSHZH-në, siç dhe kur është e nevojshme nga FSHZH-ja për të përfunduar Projektin; dhe
- (iii) do të marrë çdo masë, sipas ligjit shqiptar, të nevojshme për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV Përfaqësimi

4.01 Përfaqësues i autorizuar

Çdo veprim i kërkuar apo lejuar për t'u ndërmarrë, dhe çdo dokument i kërkuar apo i lejuar për t'u nënshkruar, sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet ose nënshkruhet:

- a) në emër të FSHZH-së, nga Drejtori ekzekutiv i FSHZH-së, ose një përfaqësues i caktuar;
- b) në emër të Marrësit, nga Ministri i Financave, ose një përfaqësues i caktuar; ose
- c) në emër të Bankës, nga Drejtori, Departamenti i Prokurimit të Konsulencës dhe Korporatave, ose një përfaqësues i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftime ose kërkesa

Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim që kërkohet ose lejohet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim në gjuhën angleze. Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë do të konsiderohet të jetë dhënë ose bërë kur dorëzohet personalisht tek një përfaqësues i autorizuar i palës të cilës i drejtohet komunikimi ose kur i dërgohet me postë të regjistruar, *e-mail* apo faks kësaj pale në adresën e mëposhtme:

Për Marrësin:	Në vëmendje të:	Shkëlqim Cani Ministër i Financave Ministria e Financave Blv. Dëshmorët e Kombit nr. Tirana / Shqipëri Telefon: +355 4 2228405 Faks: +355 4 2228494
Për FSHZH-në:	Në vëmendje të:	Benet Beci
	Adresa:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë / Shqipëri
	Telefon:	+355 4 22 34 885
	Faks:	+355 4 22 34 885
	E mail:	adf@albaniandf.org
Për Bankën:	Adresa:	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim One Exchange Square London EC2A 2JN, United Kingdom
	Në vëmendje të:	Donald Mishaxhi Drejtuesi i Operacionit
	Telefon:	+44 207 338 7109
	Faks:	+44 207 338 7301
	E-mail:	mishaxhd@ebrd.com

- a) Njoftimi do të konsiderohet të jetë kryer si më poshtë:

- (i) në rastin e dorëzimit dorazi ose postë të regjistruar, në momentin e dorëzimit; dhe
- (ii) në rastin e e-mailit dhe fakseve, pas transmetimit të konfirmuar.
- b) Një palë mund ta ndryshojë adresën e saj për bërjen e njoftimeve ose kërkesave duke i bërë palës tjetër njoftim të arsyeshëm sipas kësaj dispozite.

Neni V **Pezullimi dhe prishja**

5.01 Njoftimi nga FSHZH-ja

FSHZH-ja do të njoftojë menjëherë Bankën për pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës, ose për çdo ngjarje që mund të çojnë në pezullimin ose prishjen e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i disbursimeve

Nëse një prej ngjarjeve të mëposhtme do të ketë ndodhur dhe vazhdon, Banka, duke njoftuar me shkrim Marrësin, mund të pezullojë menjëherë pjesërisht ose plotësisht disbursimet e kërkueshme pas kësaj nga Konsulenti në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje:

- a) Banka do të ketë pezulluar disbursimet nga huaja ose investimet kapitale të FSHZH-së për Projektin, nëse ka.
- b) Kontrata e Konsulencës do të jetë pezulluar ose prishur në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës.
- c) FSHZH-ja nuk u ka paguar Konsulentëve elementin e taksës indirekte (duke përfshirë TVSH-në) për faturat e Konsulencave të Konsulentit në kohën e duhur në pajtim me termat e Kontratës së Konsulencës.
- d) ka ndodhur ndonjë kusht tjetër i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, ndërhyr, ose kërcënon të ndërhyjë, me kryerjen e suksesshme të Shërbimeve ose Projektit ose arritjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Prishja e kësaj Marrëveshjeje nga Banka

- a) Banka nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Marrësit mund ta prishë këtë Marrëveshje nëse:
 - (i) ndonjë prej kushteve të përmendura në dispozitën 5.02 do të vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pasi Banka do të ketë pezulluar plotësisht ose pjesërisht disbursimet që kërkohen nga Konsulenti dhe për këtë i ka bërë njoftim me shkrim Marrësit; ose
 - (ii) marrëveshja e huas ose marrëveshja e regjistrimit të kapitalit të vet për Projektin, nëse ka ose Kontrata e Konsulencës do të ketë skaduar ose është prishur në pajtim me termat e saj; ose

(iii) FSHZH-ja dhe/ose Marrësi dhe Banka bien dakord ta prishin atë në pajtim me termat e kësaj Marrëveshjeje; ose

- (iv) Donatori anulon financimin e Grantit; ose
- (v) prokurimi i ndonjë prej Shërbimeve nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje; ose
- (vi) fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në çdo rast, Banka mund ta prishë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke i bërë Marrësit një njoftim paraprak prej jo më pak se dyzet ditë.

5.04 Procedura e prishjes

Me prishjen e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me dispozitën 5.03, FSHZH-ja do të marrë masa të menjëhershme për të ulur humbjet dhe për t'i mbajtur shpenzimet e tjera sipas Kontratës së Konsulencës në një nivel minimal.

Neni VI **Të përgjithshme**

6.01 Përrjashtimi i përgjegjësisë

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Banka nuk do t'i detyrohet Marrësit, FSHZH-së ose Konsulentit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo Kontratën e Konsulencës për ndonjë humbje apo dëm qoftë ai i shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi neglizhent i Bankës. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet për asnjë veprim apo mosveprim neglizhent të Bankës, i cili shkakton vdekjen, apo dëmtimin personal të personelit të FSHZH-së apo Konsulentit apo Ekspertëve.

6.02 Zhdëmtimi

FSHZH-ja do të zhdëmtojë dhe sipas privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës mbrojtë Bankën, drejtorët, nëpunësit, punonjësit, agentët dhe kontraktuesit e saj ndaj të gjitha pretendimeve, dëmeve, kostove, shpenzimeve, detyrimeve, gjykimeve, humbjeve që rrjedhin nga ose në lidhje me një veprim apo mosveprim, qoftë me dashje, neglizhent apo tjetër, të FSHZH-së ose Konsulentit, punonjësve të tyre, nënkontraktuesve ose agentëve, apo me ndonjë shkelje prej tyre të detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës ose mosrespektimin prej tyre të ndonjë akti, rregulli ose rregulloreje.

6.03 Praktika e ndaluar

Banka, pavarësisht ndonjë mjeti tjetër ndaj shkeljes së Marrëveshjes, mund ta prishë këtë Marrëveshje menjëherë nëse Marrësi, dhe/ose FSHZH-ja, në gjykimin e Bankës, është përfshirë në praktika të ndaluara në konkurrimin për ose në ekzekutimin e Kontratës së Konsulencës.

"Praktikë korruptive" është ofrimi, dhënia, pranimi, ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo, i çdo sendi me vlerë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në veprimet e një pale tjetër në lidhje me procesin e zgjedhjes ose në ekzekutimin e Kontratës me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo një avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

"Praktikë mashtrimi" është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton, ose përpiket të çorientojë me dashje, një palë për të përfutur një përfitim financiar ose tjetër ose të shmangë një detyrim;

"Praktikë detyruese" është cenimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të cenuar apo dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo, një pale apo pronë të palës për të ndikuar në mënyrë të padrejtë veprimet e palës tjetër në lidhje me procesin e përzgjedhjes ose në ekzekutimin e Kontratës me qëllim që të përftohet ose mbahet një biznes apo një avantazh i parregullt në zhvillimin e biznesit.

"Praktikë e fshehtë" është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e destinuar për të arritur një qëllim të padrejtë, duke përfshirë ndikimin e padrejtë të veprimeve të një pale tjetër dhe përfshin çdo marrëveshje ndërmjet konsulentëve (para ose pas paraqitjes së propozimeve) e destinuar për të caktuar çmimet në nivele jokonkurrese artificiale dhe për t'i hequr FSHZH-së përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe auditimi nga Banka

FSHZH-ja do ta lejojë Bankën ose përfaqësuesit e saj të autorizuar të inspektojnë llogaritë dhe regjistrat e tyre në lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës dhe Shërbimeve dhe auditimin e këtyre llogarive nga auditët e caktuar nga Banka, nëse kjo kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimi

a) FSHZH-ja do të mbajë me shpenzimet e veta një policë të plotë sigurimi për të mbuluar çdo përgjegjësi që mund të lindë sipas dispozitës 6.02.

b) FSHZH-ja do t'i ofrojë Bankës me kërkesë të Bankës një kopje të policës së sigurimit dhe do ta lejojë Bankën të inspektojë këto dokumente përkatëse. Megjithatë, as inspektimi dhe as marrja e këtij mbulimi nuk do të përbëjnë pranim nga Banka të këtyre termave dhe as heqje dorë nga këto detyrime të FSHZH-së.

6.06 Ligji rregullues dhe zgjidhja e mos-marrëveshjeve

a) Kjo Marrëveshje do të interpretohet në pajtim me ligjin anglez. Çdo detyrim jokontraktuale që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

b) Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo shkelje, prishje apo pavlefshmëri të saj apo çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje e cila nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, do të zgjidhet me arbitrazh në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit UNICITRAL që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje. Do të ketë një (1) arbitër, dhe autoriteti emëruar për qëllimet e Rregullave UNICITRAL do të jetë LCIA (Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar). Selia dhe vendi i arbitrazhit do të jetë Londra, Angli, dhe gjuha angleze do të përdoret gjatë gjithë gjykimit në arbitrazh. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas Aktit të Arbitrazhit të vitit 1996 ose tjetër për të ankimuar çdo vendim arbitrazhi, apo për të kërkuar interpretimin paraprak të një çështjeje ligjore nga, gjykatat e Anglisë apo gjetkë. Arbitri nuk do të autorizohet të japë, dhe FSHZH-ja bie dakord se nuk do të kërkojë nga asnjë autoritet gjyqësor, ndonjë masë të përkohshme apo kompensim para vendimit ndaj Bankës, pavarësisht ndonjë dispozite të Rregullave të Arbitrazhit UNICITRAL.

c) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si heqje dorë, mospranim apo modifikim nga Banka i ndonjë imuniteti, privilegj apo përjashtimi të Bankës të dhënë në pajtim me Marrëveshjen Themeluese të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një konventë ndërkombëtare apo ndonjë ligj të zbatueshëm.

6.07 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme për hyrjen e saj në fuqi, sipas ligjit shqiptar, dhe përveç kur pezullohet apo prishet në pajtim me nenin V, mbetet në fuqi të plotë derisa të jenë përfunduar Shërbimet dhe të gjitha pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet Bankës dhe Marrësit të nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje së bashku me shtojcat e saj, të ndryshuara herë pas here në pajtim me dispozitën 6.08, përmban të gjithë mirëkuptimin dhe pëlqimin ndërmjet palëve dhe pezullon të gjitha propozimet ose marrëveshjet e tjera në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Asnjë palë nuk është mbështetur në ndonjë angazhim apo përfaqësim të bërë nga pala tjetër që nuk është kusht i kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Trashëgimtarët

Kjo Marrëveshje do të përbëjë detyrim dhe do të jetë në favor të trashëgimtarëve përkatës dhe cedimeve të lejuara të palëve në të.

6.11 Përjashtimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë të drejtë sipas aktit 1999 (Të Drejtat e Palëve të Treta) të Kontratave të zbatueshme nga ndonjë person apo subjekt që nuk është palë në të përveç personave apo subjekteve që janë trashëgimtarë ose përfitues me cedim të të drejtave të një pale që konsiderohet të jetë palë në këtë Marrëveshje.

6.12 Mbetja në fuqi e dispozitave

Dispozitat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04, dhe 6.06 do të mbeten në fuqi pas prishjes ose kalimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Gjuha angleze do të jetë gjuha e Marrëveshjes përveç kur bihet dakord ose kërkohet ndryshe nga Banka, të gjitha komunikimet, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës

së Konsulencës do të përgatiten dhe paraqiten në gjuhën angleze. Për çdo mosmarrëveshje në lidhje me gjuhën, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

6.14 Garanci të tjera

FSHZH-ja, vetë ose nëpërmjet Konsulentit, në çdo kohë dhe herë pas here, me kërkesë të Bankës do të nënshkruajë dhe paraqesë çdo dokument tjetër apo do të kryejë ato veprime të tjera që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të provojë, përmbushë ose t'i japë fuqi të plotë ligjore temave, kushteve, synimit dhe kuptimit të kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Koha me rëndësi të madhe

Koha për këtë marrëveshje është me rëndësi të madhe.

6.16 Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha përbëjnë një dhe të vetmen marrëveshje.

6.17 Logoja e BERZH-it

FSHZH-ja dhe Marrësi janë vënë në dijeni se logoja e Bankës është një markë shërbimi e regjistruar dhe FSHZH-ja nuk do ta riprodhojë këtë logo pa lejen specifike me shkrim të Bankës.

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, në gjuhën angleze, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave

.....

Ministër i Financave

Shkëlqim Cani

Datë:

PËR DHE NË EMËR TË BANKS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

.....

Andrea Baldan

Drejtues i Operacioneve

Bashkëpunimi Teknik

Datë:

SHTOJCA A

DEKLARIMI I APROVIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

SHTOJCA A

E MARRËVESHJES SË GRANTIT

DEKLARATË E APROVIMIT TË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

Për t'u nënshkruar nga FSHZH-ja dhe dërgohet me faturën(at) për Shërbimet nga Konsulenti

Fatura nr: Data e faturës: Shuma e faturës:

Marrëveshje Granti nr: C25851rev/EBSF-2013-01-17 dhe C25852rev/WBJF-2013-01-01

OL: Donald Mishaxhi

1. Në pajtim me Kontratën e Konsulencës për Mbikëqyrjen e Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale ("Shërbimet"), datë _____, të lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit ("FSHZH") dhe ("Konsulentit"); dhe në pajtim me dispozitën 2.02(d) të Marrëveshjes së Grantit për Shërbimet, datë

_____, të lidhur ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) dhe Marrësit, FSHZH-ja deklaron që:

(i) FSHZH-ja ka marrë dhe është i bindur për Shërbimet e Konsulentit që ishin kontraktuar në Kontratën e Konsulencës dhe që mbulohen nga faturat bashkëlidhur;

(ii) FSHZH-ja ka verifikuar faturën(at) dhe të gjitha dokumentet mbështetës të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e Shërbimeve kundrejt shumës(ave) të përcaktuara në skedulin B të Kontratës së Konsulencës dhe është i kënaqur që:

a) fatura(t) është (janë) një përfaqësim i saktë i Shërbimeve të dhëna nga Konsulenti; dhe

b) shuma(t) e caktuar në faturë(at) përputhet(n) me shumën(at) e përcaktuara në skedulin B të Kontratës së Konsulencës;

(iii) fatura(t) dhe të gjitha dokumentet mbështetëse janë paraqitur së bashku me Deklarimin e Aprovimit të Ekipit të Faturimit TC, Njësisë së Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesë; dhe

(iv) FSHZH-ja i ka paguar Konsulentit të gjitha taksat indirekte duke përfshirë TVSH-në në lidhje me faturat e mëparshme dhe merr përsipër të paguajë taksat indirekte duke përfshirë TVSH-në në lidhje me faturën(at) bashkëngjitur brenda 30 ditëve nga data e këtij deklarimi aprovimi.

(v) në pajtim me të gjitha detyrimet përkatëse sipas dispozitës 2.02 të Marrëveshjes së Grantit, FSHZH-ja i ka paguar drejtpërdrejt [fusni shumën] Konsulentit në lidhje me këtë faturë.

2. FSHZH-ja deklaron që duke nënshkruar këtë dokument FSHZH-ja autorizon Bankën të bëjë disbursimin e rënë dakord në Kontratën e Konsulencës për Konsulentin në emër të FSHZH-së.

Në dëshmi të kësaj, pala, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar ka nënshkruar këtë Deklaratë më(datë).

PËR DHE NË EMËR TË
Fondit Shqiptar të Zhvillimit
